



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2842 Prot.

Tiranë, më 10.07.2023

URDHËR

Nr. 77, Datë 10.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E PERIUdhËS SË APLIKIMEVE ME FORMULARËT A1/A1Z PËR MSH
2023**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 739, datë 15.12.2022, “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 32, datë 23.12.2022, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2023”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 13.03.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e periudhës së aplikimeve me formularët A1/A1Z, për MSH 2023, **në datat 12 dhe 13 korrik 2023, ora 08.00 – 16.00.**
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore Vendore dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aurora BALLIU

